



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I QARKUT KUKES

**SHPALLJE
PER LEVIZJE PARALELE DHE PRANIM NE SHERBIM CIVIL**

**Arsimi larte
niveli minimal i diplomes “Master Shkencor”**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe të Kreut II, dhe III, të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Burimet Njerezore shpallin procedurën e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil, për pozicionin:

1(nje) Specialist per projektet dhe marrëdhëniet me OJF-te pranë Drejtorisë Finances dhe Zhvillimit Rajonal.

(Kategoria e Pages IV-2)

Pozicionet më sipër, i ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës pranimit në shërbim civil.

Për të tre procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për - LEVIZJE PARALELE:	30 Prill 2026
Afati për dorëzimin e dokumentave për - PRANIM NE SHERBIM CIVIL:	5 Maj 2026

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si me sipër është:

- Nxitja dhe realizimi i bashkëpunimit me organizatat jo-qeveritare vendase ose të huaja.
- Bashkëpunimi i punës me zyrat e programim - zhvillimit të njesive të nivelit të parë të Q.Vendore për hartimin e projekteve të zhvillimit.
- Njohja e programeve të përshtatshme për institucionin për thirrjet e ndryshme si: BE dhe donator të tjerë.
- Siguron asistencën e nevojshme në procesin e lidhjes së marrëveshjeve të ndryshme për projektet dhe bashkëpunimi me OJF, në përputhje me dispozitat në fuqi.

- e) Njohjen me manualët përkatës të çdo programi të lançuar që shërbejnë në orientimin e hartimit të projekteve të përbashkët dhe zbatimit korrekt të tyre.
- f) Hartimin e relacioneve dhe prezantimeve të ndryshme në lidhje me përfshirjen e institucionit në projekte dhe partneritete të qëndrueshme.
- g) Nxitjen dhe realizimin e bashkëpunimit me organizatat jo-qeveritare vendase ose të huaja.
- h) Bën integrimin e informacionit me procesin e ecursisë së projekteve ku institucioni ben pjese brenda institucionit, si dhe raportimit tek donatori dhe Ministria e Financave.
- i) Zbatimin dhe monitorimin e projekteve në bashkëpunim me stafet e projekteve specifike, me ekspertet e kontraktuar, liderin dhe partneret sipas projekteve, njesite vendore
- j) Njohjen me rregullat e procedimit të prokurimeve publike per projektet sipas standarteve të BE-së (PRAG) dhe orientimin e ecursisë së zbatimit të projektit/projekteve.

1. LEVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA:

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda te njejtës kategori,
- b. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar nga institucioni);
- c. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.
- d. Të plotësojë kushtete dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në këtë shpallje
- e. Të ketë eksperiencë pune jo me pak se 5 vite ne administraten shtetore dhe institucionet e pavaruara

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a. Të zotërojnë diplomë te nivelit “Master Shkencor“. Edhe diploma e nivelit Bachelor duhet te jete ne te njejten fushe.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë prane njesise se burimeve njerezore te Keshillit te Qarkut Kukes per pozicionin qe deshirojne te aplikojne, dokumentat si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar ne perputhje me dokumentin tip qe e gjeni ne linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b. Fotokopje të diplomës
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h. Vertetim nga institucioni qe nuk ka mase disiplinore ne fuqi.
- i. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj

Dokumentat duhet të dorëzohen me poste apo drejtpërdrejt prane Njesise se Burimeve Njerezore te Keshillit te Qarkut Kukes brenda dates **30 Prill 2026**.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:

Në datën **30 Prill 2026**, Njesia e Burimeve Njerezore në Keshillin e Qarkut Kukes, do të shpallë në portalin “*Sherbimi Kombetar i Punesimit*”, në faqen e zyrtare te internetit të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për proceduren e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën date kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Njesia e Burimeve Njerezore, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e mos-kualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohurite mbi:

- a) Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 “Për Veteqeverisjen vendore”.
- b) Ligjin Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.
- c) Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003 “Per rregullat e etikës në administratën publike”.
- d) Ligjin Nr.119/2014 te miratuar me date 18.09.2014 “Per te drejten e informimit”
- e) Ligjin Nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave administrative të Republikës se Shqiperise”
- f) Programet nderkufitare ne kuader te Instrumenti i ndihmës së para-aderimit (IPA) midis Bashkimit European dhe Republikës se Shqiperise

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njesia e Burimeve Njerezore ne Këshillin e Qarkut Kukes do të shpallë fituesin në portalin “*Sherbimi Kombetar i Punesimit*” në faqen zyrtare te internetit të institucionit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2. PRANIMI NE SHERBIMIN CIVIL

Vetem në rast se pozicioni i cituar me siper, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, vazhdon procedura e konkurimit ne sherbimin civil. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare te internetit të Keshillit te Qarkut Kukes dhe ASPA duke filluar nga data **30 Prill 2026**

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATET:

Kushtet që duhet të plotësojë kandidatet janë:

- a. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar per kategorie qe konkuron.
- b. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vertetuar me një dokument nga institucioni);
- c. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë Mirë”;
- d. Të ketë eksperiencë pune jo me pak se 5 vite ne administraten shtetere dhe institucionet e pavaruara.
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor”, si dhe diploma e nivelit Bachelor duhet te jete ne te njejten fushe.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

- a) Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat për konkurim, të listuara në piken 1.2.
- b) Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo dorazi ne Njesine e Burimeve Njerëzore ne Keshillin e Qarkut Kukes brenda dates **05 Maj 2026**.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:

Ne daten **8 Maj 2026**, Njesia e Burimeve Njerëzore në Keshillin e Qarkut Kukes do të shpallë në portalin “*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*”, në faqen zyrtare te internetit të Keshillit te Qarkut Kukes, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e konkurimit ne Sherbimin Civil si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën date kandidatët që nuk i plotësojnë kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e mos-kualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohurite mbi:

- c) Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 “Për Veteqeverisjen vendore”.
- d) Ligjin Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.
- e) Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003 “Per rregullat e etikës në administratën publike”.
- f) Ligjin Nr.119/2014 te miratuar me date 18.09.2014 “Per te drejten e informimit”
- g) Ligjin Nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”
- h) Programet nderkufitare ne kuader te Instrumenti i ndihmës së para-aderimit (IPA) midis Bashkimit European dhe Republikës së Shqipërisë

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b) Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c) Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njesia e Burimeve do të njoftojë kandidatet në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Njesia e Burimeve Njerezore do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*”.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për proçedurën e konkurimit ne sherbimin civil, do të marrin informacion në faqen e internetit, për fazat e mëtejshme të kësaj proçedure duke filluar nga data **8 Maj 2026**